



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLËS SË PARË SHKODËR

Adresa: L. Qemal Stafa, Rr. Don Bosko, Tel&Fax +355 22 21 21 21 dhe +22 21 21 22

Nr. Rregj.Them. 1096 (31003-00415-83-2016)
Dt. Rregj. 19.04.2016

Nr. Vendimi 672 (591)
Dt. Vendimi 17.10.2016

V E N D I M
“NE EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata Administrative e Shkallës së parë Shkodër e përbërë nga:

Valbona DURRAJ – gjyqtare

Asistuar nga sekretare seance Borana Liti, sot me datë 17.10.2016, ora 14.30 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore çështjen administrative nr. rregj.Them. 1096 (31003-00415-83-2016) date 19.04.2016 që i përket palëve ndërgjyqëse:

PADITËS: Donika Prendi, e bija e Preng, e datelindjes 02/02/1969, banuese ne Lagjen "Beselidhja", Rruga "Vincens Prendushi", Pallati 105, kati 1, Lezhe, me nr. 0682190488 cel., person fizik me nipt: K37811525G, me te njejten adrese.

TE PADITUR: 1.Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhe(në mungesë).
2.Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve Tirane(në mungesë).

me pjesmarrje të: Avokatura e Shtetit Tiranë (në mungesë).

OBJEKTI: Kundërshtim akti administrative Drejtorise Rajonale te Tatimeve Lezhe "njoftim vlersimi per detyrimet" date 28.12.2015 me nr. 15068/13 prot.ne formen e gjobes per mos leshim kuponit tatimor dhe Vendimit te Drejtorise se Apelimit Tatimor date 15.03.2016 me nr. 1130/1 prot. dhe anulimin e tyre.

BAZA LIGJORE: Neni 16, 32, 154, te Kodit Procedures Civile, Ligji nr. 49/2012 "Per organizimin dhe Funksonimin e gjykatave, neni 7, 11 e vijues, Neni 109 I Ligjit nr. 9920 date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne R. Shqiperise".

Gjykata në përfundim të hetimit gjyqësor, pasi administroi provat shkresore të paraqitura, dëgjoi përfaqësuesin e palës paditëse i cili kërkoi pranimin e kerkese padisë sipas objektit të saj, në mungesë të palëve të paditura,të cilët në prapsime me shkrim

kërkojnë rrëzimin e kërkesë padisë si të pambështetur në ligj dhe prova, në mungesë të Avokaturës së Shtetit Tiranë, shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi:

VËREN se;

Paditesia subjekti fizik, Donika Prendi e rregjistruar ne organet tatimore Lezhë, i është drejtuar gjykates administrative shkalle e pare Shkoder me kerkese padi kunder anes se paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhe dhe, Drejtoria e Apelimit Tatimor Tirane, me objekt :

Kundershtim akti administrativ i Drejtorise Rajonale te Tatimeve Lezhe "Njoftim vleresimi per detyrimet" nr.15068/13 prot date 28.12.2015,gjobe per mosleshim kuponi tatimor dhe Vendimit te Drejtorise se Apelimit Tatimor nr 1130/1 date 15.03.2016 .

Gjykata referuar neneve 9, 7, 10, 11, 17, te Ligjit Nr. 49/2012 Per Organizimin dhe Funksonimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarreveshjeve Administrative, konstatoi juridiksionin gjyqesor dhe kompetencen lendore, funksionale dhe tokesore, te kesaj gjykate per shqyrtimin e kerkese-padise.

Rrethanat e ceshtjes ;

Paditesia eshte person fizik, tregtim me pakice me numer NIPT-i: K37811525G ushtron aktivitet ne nje lokal te shitjes se artikujve ushqimor me pakice.

Me date 05.11.2015, dy inspektor te Drejtorise Rajonale te Tatimeve Lezhe Liljana Dushkaj dhe Tom Kadeli jane paraqitur per kontroll tatimor ku kane mbajtur "Akt Konstatimin" e dates 05.11.2015, ne oren 12.³⁰ minuta, duke denuar me gjobe 50 000 (pesedhete mije) leke per mosleshim te kuponit tatimor. Sipas akt- njoftimit " nr.15068/13 prot date 28.12.2015 , Gjobe per mosleshim kuponi tatimor .

Kunder vendimit eshte ushtruar ankim administrative ne drejtorine e apelimit tatimore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tirane e cila me vendimin nr 1130/1 date 15.03.2016 , ka lene ne fuqi njoftim vlersimin e siper permendur.

Ne gjykim paditesia parashtroi se;

Nuk jam dakort pasi ne oren 10.⁴⁵ minuta kontrolli eshte paraqitur dhe pasi kane qendruar nje kohe, jane larguar dhe jane kthyer edhe nje here ne oren 12.³⁰ ku dhe kane perpiluar akt kontrollin, kete periudhe kohe une e kam nen venzhgim me kamera te dyqanit, ku rezulton se per rreth nje ore, qe kane qendruar ne monitorim, nuk ka patur asnje person pa kupon tatimore (kete e paraqes me cilesine e proves ne gjykate).

Nuk eshte e vertete se i kam sherbyer ndonje klienti pa i leshuar kuponin tatimor. Po te ishte i vertete pretendimi i tyre atehere organi administrative qe ka barren e proves duhej qe te shenonte se cili ishte personi qe bleu ne dyqan dhe nuk ju leshua kuponi? Nese do te ishim para kesaj situate atehere do te shenohej ne akt-konstatim personi fizik i kontrolluar, lloji i sherbimit, klienti ndaj te cilit u sherbye dhe situata e shkeljes se ligjit. Kjo nuk ka ndodhur, vendimi eshte arbitrar dhe i pa mbeshtetur ne fakte dhe duhet te anulohet nga gjykata si vendim i padrejte dhe ne shkelje te ligjit.

Ana e paditur prapsoi;

Pretendimet e subjekti nuk jane te mbeshtetura ne ligj. Administrata tatimore ka operuar ne perputhje me nenin 122 te ligjit 9920/2008, pasi ne momentin e kontrollit nuk leshonte kuponin tatimore ne shkelje te nenit 122 te ligjit 9920/2008. Pretendimet e paditeses ne kerkese padi nuk kane asnje baze ligjore dhe provuesmerie .

Gjykata veren se;

Ne nenin 122 te ligjit 9920/2008 citohet se:

Tatimpaguesi, person juridik ose fizik, tregtar, denohet ne rast se:

Nuk leshon kupon tatimor per te dokumentuar qarkullimin e realizuar te mallrave apo te sherbimeve:

i) per cdo konstatim (verifikim) te kryer, me gjobe ne masen 200 000 (dyqind mije) leke per tatimpaguesit e regjistruar si subjekte te tatimit mbi fitimin, dhe gjobe, ne masen 50 000 (pesedhjetë mije) leke per tatimpaguesit e tjere.

Ne udhezimin nr 24 "Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise" i ndryshuar

Neni 55 paragrafi 1 percakton se :

Tatimpaguesit, qe kryejne qarkullimin e mallrave dhe te sherbimeve, per te cilat pagesat nuk kryhen nepermjet bankes, jane te detyruar te instalojne dhe te perdorin sistemin fiskal, nepermjet perdorimit te pajisjeve fiskale, per regjistrimin e pagesave me para ne dore dhe per leshimin, ne menyre te detyrueshme, te kuponit tatimor.

Ne nenin 54 paragrafi 4 percakton se :

Personat e tatueshem, subjekte te tatimit mbi vleren e shtuar apo te tatimit mbi fitimin qe shesin mallra apo sherbime me pakice por nuk jane te detyruar te pajisen me arke regjistruese ose pajisje te tjera fiskale si dhe personat e tatueshem tatimpagues i tatimit te thjeshtuar mbi fitimin e biznesit te vogel, qe shesin mallra e sherbime me pakice por qe gjithashtu nuk jane te detyruar te kene arke regjistruese ose pajisje te tjera fiskale, jane te detyruar te leshojne per cdo shitje qe kryejne deftesa tatimore. Deftesa tatimore eshte e detyruar te leshohet edhe ne cdo rast tjetër qe arkat regjistruese apo pajisjet e tjera fiskale, per cfaredo arsye qofte,

Referuar faktit rezulton se kontrolli tatimore eshte bere mbi bazen e nje urdher pune nr 820 dt 05.11.2015, me program te percaktuar. Nga akt konstatimi i mbajtur ne vend me dt 05.11.2015 eshte konstatuar se subjektit tatimpagues nuk leshonte kupon tatimor dhe se proces verbal konstatimi mbane ore perpilimi, oren 10.45.

Nga prova filmike, e paraqitur nga paditesi ne cilesine e proves, rezulton se grupi I kontrollit ka qendruar per monitorim prane subjektit nga ora 12.30 e ne vazhdimesi, dhe per rreth nje ore qe kane qendruar nen monitorim nuk rezultonte që të mos jetë lëshuar kupon tatimore, në të kunderten e asaj që është përshkruar në procesverbal- konstatimin si dhe me oren e përshkruar ne te , ku eshte shkruar ora e kontrollit 10.45, nderkohe qe kontrolli ka qene nga ora 12.30 deri ne 13.30 siç shihet dhe nga pamjet filmike qe u shikuan nga gjykata ne prezence te paleve gjate seancës gjyqsore dhe u mor me cilesinë e provës.

Përfundimisht gjykata konstaton veprimet e pa rregullta të grupit të kontrollit për orën e shënuar në proces verbalin e konstatimit ate te pa sakte 10.45 si dhe mos pershkrimin e realitetit, i cili rezulton qe subjekti ndryshe nga sa është përshkruar nga inspektoret, leshonte kupon tatimore. Përfundimisht gjykata vlereson se subjekti tatimpagues eshte ne respektim te nenit 122 te ligjit 9920/2008. Ne keto kushte veprimet e anes se paditur nuk jane ne perputhje me ligjin. Përfundimisht gjykata vendosi pranimin e kerkese padise dhe, meqënëse vlera e aktit është më e vogël se 20 fishi i pagës minimale në shkallë vendi, ky vendim është i formës së prerë, prandaj

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, bazuar në nenin 40, 41, 42 dhe 45 të ligjit nr 49/2012 "Për organizimin dhe

funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, nenit 126, 306 dhe 310 të K.Pr.Civile, ligjit 9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar,

VENDOSI

- Pranimin e kërkesë padisë.
 - Shfuqizimin e aktit administrativ "Njoftim vlerësimi tatimor" nr.15068/13 prot date 28.12.2015 i Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Lezhë si dhe të Vendimit të Drejtorisë së Apelitit Tatimor Tiranë nr 1130/1 date 15.03.2016 .
 - Ky vendim përbën titull ekzekutiv, është i formës së prerë dhe do të ekzekutohet menjëherë.
 - Shpenzimet gjyqesore (taksa e regjistrimit të kërkesë padisë 3000 lekë) në ngarkim të palës së paditur.
 - Kundër vendimit nuk lejohet ankim.
 - Ti komunikohet vendimi palëve të paditura Drejtorisë Rajonale Tatimore Lezhë Drejtorisë së Apelitit Tatimor Tirane, dhe Avokaturës së Shtetit Tiranë (në mungesë).
- Shkoder me date 17.10.2016**

SEKRETARE SEANCE

Borana LITI



GJYQTARE

Valbona DURRAJ

